



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2018:023836

Datë: 12.04.2021

Numri i dokumentit: 01676316

P.nr. 375/16

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PEJË-DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM, me gjyqtarin e vetëm gjykues Shaqë Curri, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Selvane Bukleta si procesmbajtëse, në çështjen penale kundër të pandehurit, D. B., për shkak të veprës penale “uzurpim i paluajtshëm i pronës së paluajtshme” nga neni 332 par.1 lidhur me par 3 , të KPRK-së, e sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë, PP/II.nr.2125/2015 me dt 13.04.2016, pas mbajtjes së seancës publike të shqyrtimit gjyqësor, të datës 17.03.2021, në prezencë të prokurorit të shtetit Lumturije Vuqetaj , të pandehurit D. B. dhe përfaqësuesit të autorizuar të dëmtuarit av. H. N., në të njëjtën ditë mori dhe shpalli publikisht, ndërsa me dt.12.04.2021, përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri

D. B., i biri i U. dhe nënës N., e gjinisë M., i lindur me dt., në fsh., Komuna, ku edhe banon, identifikohet në bazë të lnj.nr., ka të kryer shkollën fillore, i martuar, baba i tre fëmijëve, me profesion tregtar i pemëve, i gjendjes së mesme ekonomike, posedues i nr.tel, shqiptar, shtetas i R. së Kosovës, mbrohet në liri.

ËSHTË FAJTOR

Sepse

- Me dt. 21.10.2015 e gjere me sot ne fsh. K-, ne mënyrë te kundërligjshme e uzurpon pronën e paluajtshme te dëmtuarit S. B. dhe atë ngastrat kadastrale me nr. 54/2, 54/3, 101/1 dhe nr. 101/2 nga certifikata e pronës me nr. 01-6155-15 e dt. 20.10.2015 ne sipërfaqe te përgjithshme prej 02,22.92 ha ZK. Kliqine, ne atë mënyrë qe i panderi këtë patundshmëri e ka futur ne posedim dhe te njëjtën e shfrytëzon duke e dhënë me qera tek dëshmitari R. J. ne shume prej 600 euro ne vit, edhe pse i njëjti edhe përkundër se nuk është pronar dhe se ka ardh në dijeni se pronën ne fjale e ka blere i dëmtuari, te njëjtën nuk e liron me arsyetimin se e ka pasur te drejtën e blerjes dhe se te njëjtën e shfrytëzon qe nga pas lufta dhe kërkon qe e njëjta ti shitet nga këtu i dëmtuari ,

- Me çka ka kryer veprën penale uzurpim i paligjshëm i pronës se paluajtshme nga neni 332 par. 1 lidhur me par 3 të KPRK-së.

Andaj, gjykata konform nenit 7, 41, 42,43, 45, 46, 47, 73, 74, 75 par.1, nën par. 1.3, neni 332 par.1 lidh me par 3 të KPRK-së, dhe nenin 365 të KPP-së, të pandehurin:

E G J Y K O N

Dënim me burg ne kohëzgjatje prej 4 (katër) muaj, e në te cilin dënim do ti llogaritet edhe koha e kaluar ne paraburgim nga dt. 19.11.2019 e deri me dt. 24.12.2019 , si dhe koha e kaluar ne arrest shtëpiak nga dt. 24.12.2019 e deri me dt. 23.01.2020.

Dënimi i mbetur me burg, me pëlqimin e të pandehurit i është zëvendësuar me dënim me gjobe dhe atë ne shumen prej 500 (pesëqind) euro, te cilin dënim i pandehuri është i obliguar te paguaj ne afat prej 30 (tridhjetë) dite pas plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi

Nëse i pandehuri nuk e paguan dënimin me gjobë të cekur si më lartë brenda afatit të caktuar, atëherë dënimi me gjobë do ti shndërrohet në dënim me burg, ku një ditë burg do ti llogaritet 20 (njëzet) euro.

I pandehuri obligohet në pagimin e paushallit gjyqësor shumen prej 20 (njëzetë) euro, në afat prej 30 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

I pandehuri obligohet që të paguajë taksën për programin e kompensimit të viktimave të krimit, në shumë prej 30 (tridhjetë) euro, në afat prej 30 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

I dëmtuari S. B. me vendbanim ne fsh. K-, për realizimin e kërkesës juridike udhëzohet ne kontest civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Pejë-Departamenti i Përgjithshëm, ka ngrit aktakuzat PTH –së në Pejë, PP/II.nr.2125/2015 me dt 13.04.2016 , PP/II.nr.370/17 të dt 05.04.2017, dhe PP/II.nr.169/2018 të dt. 16.02.2018, ndaj të pandehurit D. B., për shkak të tri veprave penale “uzurpim i paluajtshëm i pronës së paluajtshme” nga neni 332 par.1, të KPRK-së.

Me dt.17.03.2021, është mbajtur seanca e shqyrtimit kryesor ku prezent ishin prokurori i shtetit, Lumturije Vuçetaj, i pandehuri D. B. dhe përf. i aut. i të dëmtuarit S. B., av. H. N..

Gjykata konform dispozitave te nenit 323 të KPP-së, e ka udhëzuar të pandehurin me të drejtat e tij, ku në këtë rast i pandehuri deklaroi se e ka kuptuar këto të drejta dhe ka shtuar se për mbrojtës nuk ka nevojë.

Para leximit të aktakuzave, prokurorja e shtetit ka deklaruar se meqenëse në këtë fazë të procedurës e përfaqëson çështjen penale kundër të pandehurit D. B. dhe atë sipas aktakuzave PP/II.nr.2125/2015 me dt.13.04.2016, PP/II.nr.370/17 të dt 05.04.2017 dhe PP/II.nr.169/2018 të dt. 16.02.2018, ku për të njëjtat kjo gjykatë ka marr aktvendim nën P.nr. 375/16, e dt. 16.04.2019, me të cilën ka bërë bashkimin e procedurës penale në të tri aktakuzat e sipërsënuara, andaj në këtë drejtim pas vlerësimit ka konstatuar se kemi të bëjmë me të njëjtin

të pandehur dhe me të njëjtin të dëmtuar, si dhe me të njëjtin objekt lëndor dhe atë patundshmërinë e evidentuar në certifikatën e pronës nr. 01-6155-15, e dt. 20.10.2015, për ngastrat 54/2, 54/3, 101/1, dhe 101/2, në sipërfaqe prej 02.22.92 ha, ZK Kliqinë, andaj pas parasysh se aktakuza më e hershme rezulton të jetë PP/II.nr.2125/15, e dt. 13.04.2016, e cila kohën e kryerjes e ka nga dt. 21.10.2015 e gjer me sot i konsumon dy aktakuzat të mëvonshme dhe atë: me nr. PP/II.nr.370/17 të dt. 05.04.2017 dhe PP/II.nr.169/2018 të dt. 16.02.2018, gjersa mbështetur në të lartcekurat si dhe në aktgjykimin P.nr. 473/13, i dt. 11.10.2017, bëj plotësimin e kualifikimit të veprës penale për aktakuzën me nr. PP/II.nr.2125/15, e dt. 13.04.2016 dhe atë me çka ka kryer veprën penale uzurpim i paligjshëm i pronës së paluajtshme nga neni 332 par.1, lidhur me par.3, të KPRK-së, ndërsa për aktakuzat e sipërsënuar dhe atë: PP/II.nr.370/17 të dt 05.04.2017 dhe PP/II.nr.169/2018 të dt. 16.02.2018, heq dorë nga të njëjtat për shkak të rrethanave e lartcekura, gjersa procedura zhvillohet për aktakuzën PP/II.nr. 2125/15, e dt. 13.04.2016.

Pasi qe prokurorja e shtetit para leximit te aktakuzës është tërhequr nga aktakuzat PP/II.nr.370/17 të dt. 05.04.2017 dhe PP/II.nr.169/2018 të dt. 16.02.2018, gjykata te njëjtën ditë ka mare aktvendim mbi hedhjen e aktakuzave dhe ka pushuar procedurën penale kundër të pandehurit D. B., për shkak të dy veprave penale uzurpim i paligjshëm i pronës së paluajtshme nga neni 332 par.1, të KPRK-së, sipas aktakuzave PP/II.nr.370/17 të dt 05.04.2017 dhe PP/II.nr.169/2018 të dt. 16.02.2018,.

Gjykata me pas ka vazhduar shqyrtimin gjyqësor ndaj të pandehurit D. B. sipas aktakuzës se përmirësuar dhe rikualifikuar me nr. PP/II.nr.2125/15, e dt. 13.04.2016. Pas leximit te kësaj aktakuze nga prokurori i shtetit, gjykata pasi që është bindur se i pandehuri e ka kuptuar aktakuzën, i ka dhënë mundësi të pandehurit qe të deklarohet për pranimin ose mospranimin e fajësisë, duke e njoftuar për rëndësinë dhe pasojat e pranimin të fajësisë.

I pandehuri ka deklaruar se e pranon fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë, ka shprehur pendimin për veprën e kryer dhe ka premtuar se në të ardhmen nuk do të përsëris vepra tjera penale, ka shtuar se me të dëmtuarin janë pajtuar kanë arritur marrëveshje lidhur me këtë pronë dhe tani më nuk kanë asnjë problem.

Përf. i aut. i të dëmtuarit av. H. N., lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e te te pandehurit ka deklaruar se pajtohet me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, është e vërtetë se palët në këtë procedurë penale janë pajtuar në pjesëmarrjen e të pandehurit, të dëmtuarit S. B. dhe vëllait të pandehurit Astrit Berisha, me vendbanim në fsh. Kliqinë, K. Pejë, si dhe disa nga bashkëfshatarët dhe kanë arritur marrëveshje lidhur me rrethanën se i pandehuri si tani gjithashtu edhe në të ardhmen shprehimisht heq dorë në uzurpimin eventual kundërligjor në paluajtshmërinë e të dëmtuarit.

Gjyqtari i vetëm gjykues, ka marrë mendimin nga Prokurori i Shtetit, ku prokurori i shtetit ka deklaruar se, pajtohet me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, pasi qe kz pranim ka mbështetje edhe në provat materialë qe gjenden në shkresat e lëndës. I ka propozuar gjykatës qe pranimin e fajësie nga ana e të pandehurit ta merë si rrethanë

Duke pasur parasysh të lartcekurat gjykata e ka aprovuar pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit dhe ka vërtetuar se nuk ekziston ndonjë rrethanë për hudhje të aktakuzës dhe se janë plotësuar kushtet nga neni 326 lidhur me nenin 248 të KPPK-së, atëherë në këtë çështje nuk është zbatuar procedura e provave, por gjykata ka vazhduar me fjalën përfundimtare të palëve dhe me shqiptimin e dënimit.

Prokurori Lumturije Vuçetaj në fjalën e saj përfundimtare ka deklaruar se: meqenëse i pandehuri e pranoi fajësinë, u vërtetua gjendja faktike siç është përshkruar në dispozitiv të aktakuzës, andaj i propozon gjykatës që të njëjtin ta shpall fajtor, ta dënojë sipas ligjit dhe ta obligojë në paguarjen e shpenzimeve procedurale, ndërsa me rastin e marrjes së vendimit mbi dënim si rrethanë lehtësuese ta merr parasysh pranimin e fajësisë, pajtimin dhe marrëveshjen me të dëmtuarin.

Përf. i aut. i të dëmtuarit av. H. N. në fjalën e tij përfundimtare ka deklaruar se nuk parashtronë kërkesë pasurore juridike ndaj të pandehurit, është e vërtetë se janë pajtuar dhe tani këtu i pandehuri e ka liruar pronën e uzurpuar.

I pandehuri D. B., në fjalën përfundimtare ka deklaruar se kërkon falje palës së dëmtuar, premtos se në të ardhmen nuk do të përsëris asnjë vepër tjetër penale.

Gjyqtari i vetëm gjykues, është i bindur, se pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit është bërë, pasi që i pandehuri e kupton natyrën dhe pasojat e pranimin të fajit, dhe pranimi i fajit mbështetet edhe në faktet e çështjes dhe provat në të cilat edhe mbështet aktakuza siç janë: raporti i policit H. K. i dt. 21.10.2015, deklarata e dëshmitarit I. S. e dhënë ne polici me dt. 21.10.2015, deklarata e dëshmitarit R. J. e dhënë ne polici ne dt. 04.11.2015, certifikata e pronës me nr. 01-6155-15 e dt. 20.10.2015 ZK- Kliqine, kopja e planit e dt. 20.10.2015, deklarata e te pandehurit D. B. e dhënë ne stacionin policor ne Pejë me dt. 04.11.2015, si dhe shkresat tjera te lendes, pastaj aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore, ose gabim faktik, prandaj gjykata konform nenit 248 par 4 të KPP-së , ka pranuar pranimin e fajësisë nga i pandehuri.

Me provat e ofruara, si dhe pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit është vërtetuar gjendja faktike si në dispozitiv te aktgjykimit. Nga gjendja e vërtetuar faktike si është përshkruar në dispozitiv të aktgjykimit pa dyshim rrjedh se në veprimet e të pandehurit D. B. qëndrojnë të gjitha elementet e veprës penale “uzurpim i paluajtshëm i pronës së paluajtshme” nga neni 332 par.1 lidhur me nenin 3, të KPRK-së.

Gjykata nuk gjeti rrethana që përjashtojnë ndjekjen penale apo përgjegjësinë penale të pandehurit dhe i njëjti është penalisht përgjegjës.

Duke vendosur lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit, gjykata i ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese në kuptim të nenit 73 par.1 të KPRK-së. Kështu si rrethana lehtësuese për të pandehurit, gjykata mori pranimin e fajësisë, shprehjen e pendimit për veprën e kryer, faktin se i pandehuri deklaroi se me të dëmtuarin janë pajtuar dhe kanë arritur marrëveshje, po ashtu përfaqësuesi i autorizuar i të dëmtuarit deklaroi se i pandehuri me te dëmtuarin kanë arritur marrëveshje dhe i pandehuri e ka liruar pronën e uzurpuar, ndërsa rrethana rënduese ndaj të pandehurit gjykata nuk gjeti.

Sipas bindjes së gjyqtarit, dënimi i shqiptuar, duke i marrë për bazë rrethanat e përmendura më lartë, është dënim i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të pandehurit. Gjyqtari i vetëm gjykues, gjithashtu ka konstatuar se me këtë dënim mund të arrihet edhe qëllimi i dënimit, nga neni 41 i KPRK, i cili konsiston në parandalimin e të pandehurit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij; parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Duke u bazuar ne nenin 450 par. 1 dhe 2 nënpar 2.6 të KPPRK-se, gjykata ka përcaktuar paushallin gjyqësor në shumë prej 20 (njëzetë) euro, duke u bazuar ne shpenzimet që janë shkaktuar nga fillimi i kësaj procedure e deri ne përfundimin e saj.

Konform nenit 39 par.1, 2, 3, nënpar.3.1, të ligjit për kompensimin e viktimave të krimit, te pandehurit i obligoi në pagesën e taksë, si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Konform nenit 463 par. 2 të KPP-së, për realizimin e kërkesës pasurore juridike të dëmtuarin i udhëzoi në kontest civil.

Nga arsyet e cekura më lartë konform nenit 365 të KPP-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, ndërsa konform nenit 370 të KPP-së, gjykata përpiloj këtë aktgjykim.

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË-DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM,
P.nr.375/16, dt. 12.04.2021**

Bashkëpunëtore profesionale

Selvane Bukleta

GJYQTARI

Shaqë Curri

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet të kësaj gjykate.